



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007, 5/2009 dhe 43/2014), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 0 9 / 2 0 1 5 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Masa 123 Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore

Nënmasa Infrastruktura e tregut për aktivitete pas mbledhjes

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Mbështetja është dedikuar për investime publike nga ana e subjekteve shtetërore, partneritet publik privat ose njësi të vetëqeverisjes lokale.

I. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mbështetja financiare paguhet sipas parimit të financimit të investimeve të përfunduara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investimin.

II. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË PARASHTROHEN

Kërkesat për masë të veçantë dorëzohen në origjinal.

Një kërkesë mund të parashtrojë më së shumti 3 kërkesa veç e veç për masa të ndryshme duke i marrë parasysh të gjitha masat nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural 2015.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkesuesit e mjeteve janë të vërtetuara me:

- Programi për përkrahje financiare në zhvillimin rural për vitin 2015 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 196/2014, 67/2015, 131/2015 dhe 145/2015)
 - Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015 dhe 154/2015),
 - Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për përkrahje nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe lartësia e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masa individuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/2011, 80/2013 dhe 72/2014),
 - Rregulloren për kritere më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/2011 dhe 80/2013).
- Kërkesuesit të cilat i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 123 radhiten me pikë të përcaktuara në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural.
- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të radhiten sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës.

III. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët “Kërkesa për përkrahje financiare” me listën e dokumenteve të nevojshme mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
Bul. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 20 (ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup

IV. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për pagim nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2015 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit “MOS HAP” për Thirrjen publike nr. 09/2015 dhe shënimin e shiftrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar i dorëzimit të kërkesave është 06.12.2015. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej 08.30 deri në ora 16.30

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk